VENDIM
Nr.14, datë 3.3.2006

PËR DHËNIEN E LICENCËS PËR TRANSMETIMIN E ENERGJISË ELEKTRIKE SHOQËRISË "OPERATORI I SISTEMIT TË TRANSMETIMIT" SHA TIRANË

Në mbështetje të nenit 9, nenit 13 pika 1, germa b, 15 pika 1 të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", vendimit të Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr.27, datë 30.5.2004 "Rregullorja për procedurat e licencimit", nenet 4 pika 1 germa c, dhe 5 pika 1, vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.54, datë 23.11.2004, Bordi i Komisionerëve të ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 3.3.2006, pasi shqyrtoi kërkesën e paraqitur nga OST sh.a. për marrje licence për aktivitetin e transmetimit të energjisë elektrike, konstatoi se nga tërësia e kërkesave të parashikuara në aktet e mësipërme, OST sh.a. ka plotësuar disa prej tyre, por nuk ka plotësuar kushtet si më poshtë:

I. Në zbatim të ligjit nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike", neni 33 pika 1:

1.Ndarjen e plotë të llogarive financiare nga KESH sh.a.

II. Në zbatim të rregullores për procedurat e licencimit neni 10 germa C pika 3 dhe neni 11 pika 2 paragrafi 3, si dhe vendimit të Bordit të Komisionerëve nr.54, datë 23.11.2004, pika II:

1. Sigurimi i aktivitetit të licencuar;
2. Raporti i ekspertit kontabël;
3. Realizimi i matjes në kufijtë e funksioneve të prodhimit dhe të shpërndarjes;
4. Transferimin e plotë të aseteve të nevojshme për realizimin e aktivitetit të transmetimit për OST sh.a. në sasi dhe në vlerë, si dhe ndarjen e plotë me KESH sh.a.
5. Pasqyrimi në statutin e shoqërisë OST sh.a. të ndryshimeve në kapitalin themeltar në përputhje me urdhrin e Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 "Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. KESH Tiranë dhe krijimin e shoqërisë së re "Operatori i sistemit të transmetimit".

Për sa më sipër Bordi i Komisionerëve të ERES-s

VENDOSI:

I. Dhënien e licencës për transmetimin e energjisë elektrike shoqërisë "Operatori i sistemit të transmetimit" sh.a. me një afat kohor prej 3 vjetësh;

II. Kjo licencë jepet me kusht. Shoqëria OST sh.a. brenda afatit 31.12.2006 duhet të plotësojë kushtet e mëposhtme:

1. Ndarjen e plotë të llogarive financiare në përputhje me ligjin nr.9072, datë 22.5.2003 "Për sektorin e energjisë elektrike" neni 33, pika 1.
2. Raportin e ekspertit kontabël në zbatim të ligjit nr.7638, datë 19.11.1992 "Për shoqëritë tregtare" me të gjitha ndryshimet përkatëse neni 251, 256 dhe urdhrit të Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 "Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. KESH Tiranë dhe krijimin e shoqërisë së re "Operatori i sistemit të transmetimit" pika 3.
3. Transferimin e plotë të aseteve të nevojshme për realizimin e aktivitetit të transmetimit për OST sh.a. në zbatim të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.797, datë 4.12.2003 "Për krijimin e shoqërisë "Operatori i sistemit të transmetimit" sh.a. Tiranë", pika 4, urdhrit të Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 "Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. KESH Tiranë dhe krijimin e shoqërisë së re "Operatori i sistemit të transmetimit" pika 2.
4. Sigurimin e aktivitetit të transmetimit të energjisë elektrike në përputhje me "Rregulloren për procedurat e licencimit" neni 10 germa C pika 3.
5. Realizimin e matjes në kufijtë e funksioneve të prodhimit dhe shpërndarjes në përputhje me "Rregulloren për procedurat e licencimit" neni 11 pika 2 paragrafi 3.
6. Pasqyrimin në statutin e shoqërisë OST sh.a. të ndryshimeve në kapitalin themeltar në përputhje me urdhrin e Ministrit të Ekonomisë nr.63, datë 18.3.2004 "Për zvogëlimin e kapitalit të sh.a. "KESH" Tiranë dhe krijimin e shoqërisë së re "Operatori i sistemit të transmetimit".

3. Në përfundim të afatit të caktuar në pikën 2 të këtij vendimi, ERE rezervon të drejtën për ta rishikuar këtë vendim.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-S
Pjetër Dema